



INTESA SANPAOLO BANK

Albania

“Cmimi Universitar për Kënaqësinë e Klientit”, një mundësi e madhe për të ardhmen!

Intesa Sanpaolo i ka dhënë gjithmonë një vëmendje të veçantë Edukimit, duke shërbyer si urë që i sjell studentët pranë mjedisit real të biznesit, duke ofruar ndërkohë mundësi punësimi dhe rritjeje profesionale përmes prezencës dhe ekspertizës së saj ndërkombëtare.

Banka e mbështetur nga departamentet përkatëse në Divizionin Ndërkombëtar të Bankave të Grupit Intesa Sanpaolo, ndërmorri projektin “*Cmimi Universitar*”, i cili synon identifikimin e ideve inovative në fushën e “Kënaqësisë së Klientit”.



Nëpërmjet këtij projekti, studentët kanë mundësinë të përdorin njohuritë e tyre teorike në zhvillimin e ideve inovative mbi tema specifike, por gjithashtu edhe të testojnë aftësitë e tyre në kushte të vërteta biznesi, ku ata do të punojnë së shpejti.

Pas fazës së aplikimit 12 studentët më të mirë të përzgjedhur nga Universiteti Epoka, Universiteti European i Tiranës dhe Universiteti i Tiranës, për një periudhë 3 mujore, morrën pjesë në workshope, të ndarë në skuadra, nën monitorimin e profesionistëve të Bankes Intesa Sanpaolo.

Skuadrës fituese të përbërë nga dy studente të Universitetit të Tiranës: **Raisa Uku** e **Ermira Zhuka**, të cilat prezantuan temën inovative mbi “Projektim të një skeme shpërblyese për klientët përmes pagesave elektronike pa kontakt” iu dorëzua nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, **Z. Fullani**, Cmimi i Parë. Ky cmim përfshin: “*Një Internship të paguar pranë Intesa Sanpaolo Bank Albania*” si dhe përfaqësimi i Shqipërisë në fazën e dytë të konkursit pranë Divizionit Ndërkombëtar të Bankave, Filiale të Grupit Intesa Sanpaolo në Milano, duke pasur kështu mundësinë të fitojnë një Internship Ndërkombëtar në zyrat qendrore në Itali.

Ceremonia e shpalljes së projektit më të mirë u zhvillua në ambientet e Bankës Intesa Sanpaolo në prezencën e Guvernatorit të Shqipërisë **Z. Fullani**; Ministrit të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, **Z. Veliaj**; Ambasadorit Italian, **Z. Gaiani** dhe përfaqësuesve të Universiteteve.

Ky konkurs do të jetë një organizim i përvitshëm, i cili do të cojë më përpara zhvillimin e një platforme inovacioni si dhe do të ndërtojë ura bashkëpunimi midis bankës dhe universiteteve në Shqipëri.

Me Respekt,
Departamenti i Marrëdhënieve dhe Kujdesit ndaj Klientit.

Për informacione të mëtejshme Ju lutemi të kontaktoni Menaxherin tuaj të Marrëdhënieve me Bankën, i cili është në dispozicion edhe në rastet kur nuk dëshironi të merrni komunikim elektronik.

www.intesasanpaolobank.al

Asistencë Teknike

Tel: 08006000 (Falas) / Tel: +355 4 22 76 000/222/223 / Cel: +355 692080903